



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-14991/25 datë:30.06.2025



Npi – 01/237 datë: 04.07.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 04.07.2025 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -VII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

E mbajtur më datën: 04.07.2025 (e premte) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu dhe z.Muhamet Ademaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Asistentja e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarja për Informim dhe znj.Vlora Hyseni. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 25.06.2025,
2. Raporti i përgjithshëm gjashtë mujor i punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit, miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 25.06.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Shqiprim Hyseni: Desha vetëm me ju kërkuar falje që procesverbali nga mbledhja e kaluar, ju ka ardhur me vonesë, arsyeja ka qenë se ishte shumë frik që kanë ndodhur njëra mbledhje me tjetrën, edhe për shkak të ngarkesës me punët e tjera nuk kemi arritur me shkruar me kohë për me dërguar materialin bashkë me ftesën për mbledhje, prandaj kërkoj mirkuptimin tuaj. Jamë munduar me bërë në mënyrën më të mirë të mundshme. Besoj keni me votuar të gjithë nëse vetëm e keni lexuar.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimit miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 25.06.2025.**

Pika 2

Raporti i përgjithshëm gjashtë mujor i punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë. Ky raport është prezantuar ashtu siç e thot ligji edhe me qytetarët e komunës. Kryetari pra është i obliguar që të raportojë, dhe ky

takim është mbajtur menjëher pas seancës së Kuvendit që patëm, dikush ka qenë pjesëmarrës. Sot nuk i kemi këtu Ekzekutivin që ta elaborojmë këtë raport, por materialin e kemi marrë me kohë dhe nëse keni diçka mundë të diskutojmë. Unë kisha rekomanduar që Zyra e Kryetarit ose dikush nga Ekzekutivi të na raportojë në seancën e Kuvendit, ndërsa këtu ne mundemi me fol si anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Materialin e kemi marrë me vonesë, gjithashtu është kogja vuluminoz për ta lexuar gjë që nuk kemi arritur. Pajtohem me rekomandimin tuaj që në mbledhje të Kuvendit të vije Kryetari ose dikush nga Ekzekutivi edhe të na prezantojë këtë raport. Pajtohem me ty që pa u fillu debatet në Kuvend, dikush nga Ekzekutivi të na prezantoj në mënyrë fizike këtë raport.

z.Muhamet Ademaj: Përshëndetje. Sa i përket raportit të përgjithshëm të Kryetarit, për 6 mujorin e parë të vitit 2025 teknikisht është përgadit mirë, se na ka ardhur materiali e kemi parë, mirëpo unë si anëtar i Kuvendit po i shprehu disa shqetësime në lidhje me projektet kapitale që po realizohen në Komunën e Shtimes. Po filloj me një projekt ku e kemi trotuarin te rruga “Hyrë Emini” është mirë me qenë edhe drejtorat këtu në Komitet, edhe ata duhet me marrë pjesë, mirëpo nuk qenkan këtu, e shqetësimet e mia do ti përcjelli edhe te mbledhja e Kuvendit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Me fal prof Drejtori i Urbanizmit është në pushim vetëm thash ta jap këtë informatë.

z.Muhamet Ademaj: Vitin e kaluar, e kamë bërë këtë kërkesë, ajo rrugë është edhe e rrezikshme për këmbësor, sepse tash është shtuar edhe numri i automjeteve që qarkullojnë për Jezerc, prandaj po kanë vështërsi me i çitë edhe fëmijët në rrugë se po tuten prej veturave. Vitin e kaluar e kamë kërkuar pse nuk po realizohet, më kanë thanë se i ka marrë përmbaruesi, d.m.th u banën katër vite dhe nuk po realizohet. Një shqetësim e kamë edhe unë te rruga “Kruja” një aneks vet e kamë propozuar atë rrugë, bile Rrezarta e ka propozuar, edhe ai projekt nuk po realizohet, se ku ka shkuar ai projekt, me shikuar aty te drejtori ai thotë që është realizuar ai projekt, mirëpo se ku u ndërtu nuk po muj me ditë, nuk jamë hetues. Tjetër, vitin e kaluar e kamë propozuar, kanalizimin te lagja e “Robojve”. Qat lagje prej se e mbaj mend kurrë asnjë sen shteti as PDK as VV nuk ka investuar, është shqetësim se edhe ata banor janë qytetarë të komunës së Shtimes. Tjetër e kemi edhe një rrugë “Mihajl Grameno” në Davidoc, e di që drejtori i ka përfunduar gjitha ato rrugë por qat rrugë ende seshte përfunduar. Edhe na Petrovalit kemi shqetësim për ujin e pijshëm në shkollën e Petrovës, ku edhe qeverisja e kaluar por edhe kjo qeverisje nuk ka bërë zgjidhje për me siguru ujin e pijshëm për 500 nxënës të kësaj shkolle. Unë po kërkoj, që nëse qito projekte nuk realizohen, buxheti ka me ardhur shumë shpejt, unë nuk e di për kend me votuar. Qito projektet e mia nuk po realizohen në teren. Propozojë, Kryesues që me biseduar, që bile deri ka Shtatori kur ta kemi miratimin e buxhetit me u realizuar qito projekte që unë i kamë kërkuar, janë projekte të qytetarëve nuk janë të miat, për ndryshe unë sot do të “abstenojë” si shenjë revolte që nuk po realizohen këto projekte, kështu që kisha kërkuar edhe te Kryetari edhe te këta tjerët që me u realizuar këto projekte. Qito janë ato shqetësimet e mia.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Çështja është se te “Lagja e Robojve”, aty në vitin 2022 është bërë një rrugë që e lidhë komplet lagjen, pastaj është ndërhy edhe te varrezat e lagjes me zhavor, edhe një parking është bërë. Këtë vit është i buxhetuar kanalizimi ashtu qysh e kena votuar edhe ti edhe unë edhe gjithë, është i parapar ndriçimi në rrugën kryesore përmes shtyllave të betonit që janë bërë tash nga KEDS-i, edhe besoj që edhe këto projekte që ti i ke propozuar këtë vit. Tash na jena veç në muajin e gjashtë të vitit ku përfundojnë. E di që trotuari në Mollopolc deri te Salla e Sportit nuk ka përfunduar edhe nuk ka filluar, është shumë e vërtet ajo që përmbaruesi e ka marrë buxhetin. Fajin e ka politika në përgjithsi, nuk po du me ja hedh fajin askujt kontrata kolektive jo vetëm Shtimes por edhe komunave tjera ju ka shkaktuar shumë probleme në gjitha fushat. Shtimes ndoshta ja merr 1.5 milion por ka qytete të mdhaja si Ferizaji që vitin e kaluar ja ka marrë 6 milion për një herë ndërsa gjithësejt ja ka marr 8 milion euro, e këto zakonisht i merr te investimet kapitale, pagat nuk i merr, pjesën e pagave. Normal që na duhet me u munduar që gjitha projektet e qytetarëve me i shty përpara edhe qeverisja edhe opozita. Pozita tash në këtë kohë duhet me i shty sa më shumë projektet përpara, kjo është mirë se nuk i merr meritat veq pozita por i marrin meritat bashkërisht, mirëpo nga një herë janë disa probleme që nuk lejojnë me hec përpara, edhe

vimë deri te kjo që e thae, por ne bashkërisht kemi me u munduar me i shty të gjitha përpara. E di që në Lagjen “Ademaj”, ndoshta një aneks ka mbetur me u shtruar, por është bërë punë në secilën lagje, dhe nëse nuk bëhen këtë vit, vitin tjetër kush do që është në qeverisje, ato kanë me u bërë, sepse janë të buxhetueme edhe s’kanë qare pa u bërë, ishalla nuk e kanë fatin me i marrë përmbaruesi. Unë psh. Kamë pas rast, ku e din ti prof për kanalizimin te lagja e “Robojve” edhe pastaj më kanë thënë te Kimeti që nuk mundeni me e nisë këtë kontratë sepse Përmbaruesi i ka marrë paret që kanë qenë të buxhetueme me 15 mijë euro. Edhe janë disa probleme që përkundër dëshirës edhe vullnetit nuk mundesh me i shty përpara, tek e fundit nuk mundesh me nis projekt pa e pasur buxhetin.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”, vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Raportit të përgjithshëm gjashtë mujor të punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes, me kërkesën që në seancën e Kuvendit të prezantohet dhe të shërohet kjo pikë nga personi kompetent.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime të tjera nuk ka, mbledhjen e përfundoj në ora 10:40h.

Procesmbajtësi
Shqiprim Hyseni



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

